

VENDIM
Nr.283, datë 6.4.2011

**PËR KALIMIN E SIPËRFAQES 2570.5 M², PRONË SHTETËRORE, NË PËRGJEGJËSI
ADMINISTRIMI TË MINISTRISË SË DREJTËSISË PËR NDJEKJEN E
PROCEDURAVE LIGJORE QË NEVOJITEN PËR NDËRTIMIN E XHAMISË
“NAMAZGJAJA”, PËR KOMUNITETIN MYSLIMAN SHQIPTAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 8, 10, 11 e 13 të ligjit nr.8743, datë 22.1.2011 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Sipërfaqja prej 2570.5 (dymijë e pesëqind e shtatëdhjetë pikë pesë) m², e ndodhur në zonën kadastrale 8150, me numër pasurie 1/82, pjesë e pronës së listuar me nr.592, me sipërfaqe të përgjithshme 6739 (gjashtë mijë e shtatëqind e tridhjetë e nëntë) m², në listën e miratuar me vendimin nr.834, datë 13.12.2006 “Për miratimin e listës së pjesshme (pjesa e parë dhe e dytë) të pronave të paluajtshme shtetërore, në Bashkinë Tiranë të qarkut të Tiranës”, pronë shtetërore, sipas planit të rilevimit, që i bashkëlidhet këtij vendimi, kalon në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Drejtësisë, me qëllim ndjekjen e procedurave ligjore që nevojiten për ndërtimin e xhamisë “Namazgjaja”, për Komunitetin Mysliman Shqiptar.

2. Ndalohej tjetërsimi apo dhënia në përdorim e pronës së përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi, për qëllime të tjera, të ndryshme nga ndërtimi i xhamisë “Namazgjaja” e Tiranës, për Komunitetin Mysliman Shqiptar.

3. Ngarkohen Ministri i Drejtësisë, Kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë, Agjencia e Kthimit dhe e Kompensimit të Pronave dhe Agjencia e Inventarizimit dhe Transferimit të Pronave Publike për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha